



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1166/7 prot.

Datë 13.07.2022

V E N D I M

Nr. 660/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “ERALD-G” SHPK, “E.B.S” SHPK, “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” SHPK, “HYDRO-ENG CONSULTING” SHPK, M.A.K Studio” SHPK, “MAGNA CHARTA” SHPK, “CIVIL CONS” SHPK, “G & L CONSTRUCTION” SHPK, “INFRATECH” SHPK, “PROJECT DALUZ 2019” SHPK, “BN PROJECT” SHPK dhe “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM “IKN”” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt “Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica” me fond limit: 1,293,427.0 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e shtatë). lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” SHPK

Adresa: Njësia bashkiake nr. 8, Shenasi Dishnica, nr.
Pasurie 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A.
Adresa: Rruga Kavajës Nr.133, Njësia administrative
Nr.6, Kodi Postar 1027.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik "ERALD-G" SHPK
Adresa: Dibër, Maqellare, HERBEL, Zyra në katin e
parë, banesa 2-katëshe në lindje të fshatit herbel,
Komuna Maqellarë.

Operatori ekonomik "E.B.S" SHPK
Adresa: Kashar Tiranë Kashar, YZBERISH, Rruga "
Teodor Keko", pallati " ALES Konstruksion", shkalla
nr.1, kati 7-të.

Operatori ekonomik "INSTITUTI DEKLIADA - ALB"
SHPK
Adresa: Tiranë, Rruga Donika Kastrioti, pallati
Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001.

Operatori ekonomik "HYDRO-ENG CONSULTING"
SHPK
Adresa: Durrës, Rruga Ahmet Ramzoti, Lagjja nr.18,
Rajoni nr. 5, nr. Pasurie 29/70+1-211, Zona kadastrale
8511.

Operatori ekonomik "M.A.K Studio" SHPK
Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Muhedin
Llagani, Pallat 12- katësh (VALA), Kati 1, Nr. 7.

Operatori ekonomik "MAGNA CHARTA" SHPK
Adresa: Tiranë, Rruga Hysni Gerbolli, Njësia Bashkiake
nr.11.

Operatori ekonomik "CIVIL CONS" SHPK
Adresa: Gjirokastër, Lagjja 18 Shtatori, Rruga "18
Shtatori", godinë 9-katëshe, kati 1-rë, objekti 15/5.

Operatori ekonomik "G & L CONSTRUCTION" SHPK

Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.6, Rruga e Qelqit, Pallatet e firmë Derveni, Kulla 8, Njësia nr.4, Kombinat.

Operatori ekonomik "INFRATECH" SHPK

Adresa: Tiranë, Rruga Besim Imami, pallati 12-katesh, kati i 2-te, nr.13.

Operatori ekonomik "PROJECT DALUZ 2019" SHPK

Adresa: Tiranë, Rruga "Besim Mema" 103, Kati i Parë, Ap. 8, Zip 1001.

Operatori ekonomik "BN PROJECT" SHPK

Adresa: Tiranë, Njësia Administrative nr. 4, Pallati nr. 9, Hyrja 1, Njësia 6.

Operatori ekonomik "INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM "IKN"" SHPK

Adresa: Farkë, Tiranë, Rruga Eduard Mano, Pallati 20, Kati 0.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit,

në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2022, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt “Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica” me fond limit: 1,293,427.0 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzetë e shtatë). lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

II.2. Në datën 16.05.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.2. Në datën 23.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi rezultatin e vlerësimit nga KVO të ofertave të paraqitura dhe klasifikimin e tyre, si më poshtë vijon:

1. “Tower” SHPK	1,040,500	I skualifikuar
2. “ERALD-G” SHPK	1,121,229	I kualifikuar
3. “G & L CONSTRUCTION” SHPK	1,137,100	I kualifikuar
4. “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"” SHPK	1,138,216	I kualifikuar
5. “E.B.S” SHPK	1,162,000	I kualifikuar
6. “INFRATECH” SHPK	1,164,010	I kualifikuar
7. “CIVIL CONS” SHPK	1,169,399.69	I kualifikuar
8. “NOVATECH STUDIO” SHPK	1,176,269	I kualifikuar
9. “M.A.K Studio” SHPK	1,176,891	I kualifikuar
10. “BN PROJECT” SHPK	1,177,107	I kualifikuar
11. BOE“HYDRO-ENG CONSULTING” SHPK & “PCS” SHPK	1,177,107	I kualifikuar
12. “MAGNA CHARTA” SHPK	1,177,107	I kualifikuar
13. “PROJECT DALUZ 2019” SHPK	1,177,440	I kualifikuar
14. “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” SHPK	1,177,440.62	I kualifikuar

II.3. Në datën 30.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 72, datë 06.06.2022.

II.4. Në datën 01.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1166/2022 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2243 e operatorit ekonomik “NOVATECH STUDIO” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ERALD-G” SHPK, mbi mënyrën e përlogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit si dhe kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar E.B.S SHPK, INSTITUTI DEKLIADA – ALB SHPK, HYDRO-ENG CONSULTING SHPK, M.A.K Studio SHPK, MAGNA CHARTA SHPK, CIVIL CONS SHPK, G & L CONSTRUCTION SHPK, INFRATECH SHPK, PROJECT DALUZ 2019 SHPK, BN PROJECT SHPK, INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" SHPK.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1166/2022/2 prot., datë 02.06.2022 lidhur me pretendimet e kualifikimit të ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendimet, në këtë procedurë prokurimi objekt-ankimimi.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 8653/39 prot., datë 07.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1166/3 prot., datë 09.06.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NOVATECH STUDIO” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke e refuzuar atë.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1166/4 prot., datë 24.06.2022, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Kërkesë për ekspertizë” mbi përlogaritjen e vlerës së shërbimit të mbikëqyrjes në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt “Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica” me fond limit: 1,293,427.0 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e shtatë). lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 5039/1 prot., datë 06.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1166/6 prot., datë 07.07.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa “Kthim-përgjigjeje” e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë cituar si më poshtë

vijon: “Në vijim të kërkesës suaj nr. 1166/4 prot., datë 24.06.2022, për dhënie ekspertize për mënyrën e vlerësimit teknik nëse autoriteti kontraktor ka përllogaritur në përputhje me sa parashikohet në Vendimin nr. 354 datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” vlerën minimale dhe maksimale, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt “Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica”, duke gjykuar nga materiali bashkëlidhur kërkesës konstatojmë se: Autoriteti kontraktor ka ndjekur hapat e parashikuara në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 në përllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale”.

II.9. Nga verifikimet e kryera, rezulton se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “NOVATECH STUDIO” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NOVATECH STUDIO” SHPK, me arsyen: “1.- Mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor..

Shënim sipas DST: Kandidati ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përllogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

2.- Operatori ERALD-G SHPK.

3.- Kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar E.B.S SHPK, INSTITUTI DEKLIADA – ALB SHPK, HYDRO-ENG CONSULTING SHPK, M.A.K Studio SHPK, MAGNA CHARTA SHPK, CIVIL CONS SHPK, G & L CONSTRUCTION SHPK,

INFRATECH SHPK, PROJECT DALUZ 2019 SHPK, BN PROJECT SHPK, INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, pikat 2.3.4, të kapacitetit teknik, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet t'i referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlllogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “NOVATECH STUDIO” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin e Ofertës (sipas shtojcës 1).
- Lista e Çmimeve të Shërbimeve (sipas shtojcës 2).

III.1.4. Në nenin 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 41, pika 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Njoftim Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

III.1.7. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.9. KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes “NOVATECH STUDIO” SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendimet, për mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e veçantë të vendosur. Konkretisht nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet t’i referohen njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit

të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tij do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga AK (në bazë të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr. 5585, datë 27.07.2017). Pra, ky kriter është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016, si dhe njoftimit të APP-së nr. 5585, datë 27.07.2017. Në këto kushte çdo ofertues pjesëmarrës i interesuar duhet të dorëzojë ofertën ekonomike të përlogaritur sipas bazës ligjore të sipërcituar, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Sikundër pasqyruar më sipër për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykoi të nevojshme t'i drejtohej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke kërkuar ekspertizë mbi përlogaritjen e vlerës së shërbimit të mbikëqyrjes në procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar" me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt "Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica" me fond limit: 1,293,427.0 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzetë e shtatë). lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A. Referuar interpretimit të dhënë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 5039/1 prot., datë 06.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1166/6 prot., datë 07.07.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa "Kthim-përgjigjeje" e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë cituar si më poshtë vijon: "Në vijim të kërkesës suaj nr. 1166/4 prot., datë 24.06.2022, për dhënie ekspertize për mënyrën e vlerësimit teknik nëse autoriteti kontraktor ka përlogaritur në përputhje me sa parashikohet në Vendimin nr. 354 datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" vlerën minimale dhe maksimale, në procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar" me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt "Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica", duke gjykuar nga materiali bashkëlidhur kërkesës konstatojmë se: Autoriteti kontraktor ka ndjekur hapat e parashikuara në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 në përlogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale".

Referuar dispozitës ligjore në fushën e mbikëqyrjes, konkretisht VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", KPP sqaron se, autoriteti kontraktor për përlogaritjen e fondit për shërbimet e parashikuara të kërkuara sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, duhet të ketë në konsideratë hapat e parashikuar, në varësi të kategorisë dhe grupit tarifor si dhe fondit të procedurës së punës që është kërkuar për t'u realizuar ky shërbim, ku bën pjesë objekti i prokurimit, si referuar korrespondencës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas së cilës ka konfirmuar që Autoriteti kontraktor ka ndjekur hapat e parashikuara sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 në përlogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale. Ndërkohë, vetë autoriteti kontraktor ka pranuar që ka kryer përlogaritjen e fondit

limit të procedurës objekt-ankimi sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016. Për sa është parashtruar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se autoriteti kontraktor ka ndjekur të gjithë hapat e kërkuar sipas VKM 354. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të ligjit të prokurimit publik. Gjithashtu, është në diskrecionin e autoritetit kontraktor, për mënyrën, se si do të prokurojë shërbimin e mbikëqyrjes së kërkuar për objektin *“Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica”*, sipas kriterëve teknike të hartuara nga vetë autoriteti kontraktor, referuar mbi bazën e njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Sa më sipër konstatuar, si dhe referuar edhe korrespondencës së kryer me institucionin kompetent Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues “NOVATECH STUDIO” SHPK për procedurën e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”* me Nr. REF-27331-05-04-2022 me objekt *“Loti 4 Mbikëqyrje e punimeve për objektin Ndërrim rrjet kanalizimi blloku i kufizuar nga Rrugët Dervish Hima, Faik Konica”* me fond limit: 1,293,427.0 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e shtatë). lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “NOVATECH STUDIO” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

